

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurit: F. H. nga P., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6179/15 të datës 15.03.2016, jashtë seancës, me datë 23.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm për shqiptimin PP.II.nr. 6179/15 të datës 15.03.2016 e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari;

F. H., i ati H. , i lindur më dt: *data e lindjes...*, në fsh.B. KK.P.,ku edhe jeton,shqipëtar, – shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datë 15.10.2015, rreth orës 07:30, në magjistrale Podujevë-Prishtinë, e pikërisht në fsh.Vranidoll, i pandehuri me automjetin e markës “VW 70X02D” ngjyrë portokalli, me targë *numri i targave...*, ka qenë i përfshirë në aksidentin e trafikut, i cila në kundërshtim me nenin 126.1 të LSKRR-së, nga pakujdesia duke menduar lehtë se në atë mënyrë nuk do ta rrezikoi jetën e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion , nuk e ka mbajtur distancën e mjaftueshme në mes të veturave, ashtu që me pjesën e përparme të majtë të automjetit të tij godet në pjesën e pasme të djathtë automjetin e markës “Peugeot Partner”, ngjyrë e gjelbër metalike, me targa *numri i targave...*, të cilën e drejtonte tani i dëmtuari M. B., me ç’rast është shkaktuar aksident trafiku me dëme material dhe lëndime të lehta trupore, -

-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind e gjashtëdhjetë) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mundë ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prere e këtij aktgjykimi.

Në rast se e pandehura nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **40.88** euro për ekspertizën e komunikacionit, shumën prej **20** euro te ekspertizës mjeko-ligjore, si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **20** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

I dëmtuari: M. B., me vendbanim në fsh.B. KK.P. , lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 6179/15 të datës 15.03.2016, kundër F. H. nga P., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarës sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akuzuarës të lëshoj Urdhrit Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se e akuzuara e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Ekspertiza e komunikacionit e datës 17.12.2015, Ekspertiza mjeko-ligjore e datës 24.01.2016, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se e akuzuara ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarës ekzistojnë elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 1 lidhur me par 6 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën par 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr. 1603/16, të dt. 23.10.2017

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.